



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:017307

Datë: 15.07.2019

Numri i dokumentit: 00409422

P.nr. 325/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHEM, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurit M M nga Peja, i akuzuar për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PP/II. nr.737/2018, të dt.15.05.2018, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë në seancën fillestare të datës, 04.07.2019, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Ardita Beqiraj, të pandehurit M M mbrojtësit së tij Faruk Binakaj sipas detyrës zyrtare, në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me dt.15.07.2019, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

M M, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit nr...., i lindur me ..., në Pejë, rr.”...” nr. ..., i biri i A dhe nënës N, e gjinisë M, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion automekanik, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon tel.nr. ..., shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORË

Sepse,

- Me date 02.04.2018 rreth orës 23:30, në Pejë, në rrugën O i pandehuri deri sa ishte duke lëvizur me automjet ka shtënë me pistoletë pa ndonjë qëllim disa here në ajër deri sa ishte duke drejtuar automjetin dhe ka vazhduar ngasjen në rrugët e qytetit dhe është ndaluar në hyrje të spitalit të regjionit të Pejës rr.” ...”, dhe me rastin e bastisjes nga ana e policisë i është gjetur një thikë e llojit (flutur) dhe pastaj nën ulësen e përparme të

automjetit është gjetur edhe pistoleta e llojit B cal, 9mm me numër serik 16-1600127 dhe rreth 25 plumba të njëjtit kalibër .

-Me çka ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në aplikim të në nenin 7, 42, 43 par 1 nen par 1.3, 46 , 49 par. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75 neni 1, par. 1.3 62, 69, 73, dhe nenit 375 par.2, nenit 247, dhe 365, të KPRK-së, të pandehur:

E G J Y K O N

Dënim dhe Gjobë dhe me Kusht

- Dënim me gjobë në shumë prej 650 (gjashtëqind e pesëdhjetë) euro, të cilin dënim obligohet që ta paguaj me se largu ne afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, dhe

- Dënim me burg ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti, mirëpo ky dënim nuk do të ekzekutohen në rast se i pandehuri brenda periudhës një (1) vjeçare nuk kryen ndonjë veprë të re penale.

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë gjykata do ta zëvendësojë me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

I pandehuri obligohet në pagimin e shpenzimeve gjyqësore shumen prej 200 (dyqind) euro, dhe te paushallit gjyqësor ne shumen prej 20 (njëzet) €, gjithsej 220(dyqindenjëzet) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ndaj të pandehurit në kuptim të nenit 62 të KPRK-së, shqiptohet

DËNIMI PLOTËSUES –KONFISKOHET- një armë- pistoleta e llojit B cal 9mm me numër serik 16-1600127 dhe 25 plumba të të njëjtit kalibër, dhe një thikë e llojit (flutur).

URDHËROHET që arma e konfiskuar të shkatërrohet, pas arritjes së ekspertizës balistike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Përgjithshme, ka ngrit aktakuzë Pejë, PP/II. nr.737/2018, të dt.15.05.2018, kundër të pandehurit, M M nga Peja, i akuzuar për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së.

Bashkë me aktakuzën prokuroria i ka dërguar gjykatës edhe njoftimin për marrëveshjen e lidhur për pranimin e fajësisë, në ç mënyrë është njoftuar gjykata për detajet dhe është lutur që të mbahet shqyrtimi fillestar sa më shpejtë që është e mundur.

Gjykata me dt. 22.05.2019, 11.06.2019 dhe 27.06.2019 në këto çështje penale ka caktuar seancën fillestare, në këto seanca nuk ka qenë prezent i pandehuri M M edhe pse ishte i ftuar në mënyrë te rregullt. Gjykata me dt. 28.06.2019 ka lëshuar urdhërarrest ndaj të pandehurit M M. Polica e Kosovës duke vepruar sipas urdhërarrestit e kanë sjellë të pandehurin në gjykatë me dt. 04.07.2019, e ku në këtë raste, gjykata ka mbajtur seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, ku prezent kanë qenë prokurorja e shtetit Ardita Beqiraj, i pandehuri M M, dhe mbrojtësit se tij sipas detyrës zyrtare av. Faruk Binakaj.

Në seancën gjyqësor ku shqyrtua marrëveshja për pranimin e fajësisë mbrojtësi i të pandehurit av. Faruk Binakaj deklaroi se përkrah marrëveshjen e arritur në mes të prokurorisë dhe të mbrojturit të tij.

I pandehuri deklaroi se e pranon marrëveshjen e arritur në prokurori, dhe e pranon fajësinë sipas marrëveshjes.

Prokurori deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit sipas kushteve të marrëveshjes.

Me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, sipas nenit 247 par 1, lidhur me nenin 233 par 18 të KPP-së, gjykata fillimisht ka përcaktuar se i pandehuri ka kuptuar natyrën e veprës penale, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij dhe se nuk ka qenë i detyruar, apo shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë se pranimi i fajësisë ka mbështetje në fakte dhe prova materiale të cilat paraqitën në aktakuzë dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 253 par 1 dhe 2 të KPP-së.

Gjykata është bindur se janë plotësuar kushtet nga neni 233 par 18 i KPP-së, andaj ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe në pajtim me marrëveshjen, gjykata të pandehurit i ka shqiptuar dënimin e lartë cekur, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata për të pandehurin, mori parasysh dënimin e propozuar në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 73 par.1, të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori sjelljen e tij korrektë në gjykat, i njëjti ka pohuar se ndjen keqardhje, si dhe pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes dhe faktin se i njëjti me parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit, është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit

të dënimit në pengimin e të pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen, por ai do të ndikojë edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë, që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 dhe 2.7 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar shpenzimet gjyqësore ne shumen prej 200 euro, paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj, pasi qe në këtë çështje penal ka qenë e caktuar disa herë seanca fillestar, e ku mbrojtësi i të pandehurit ishte prezent, ndërsa i pandehur edhe pse ishte i njoftuar në mënyrë te rregullte për seancën e caktuar, nuk prezantonte në seancë për arsye te ndryshme.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me konfiskimin e sendit është marr në kuptim të nenit 62 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.325/18 dt. 15.07.2019

Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta

GJYQTARI
Shaqë Curri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.